

Në bazë të nenit 8, pika 1 e Ligjit të Punës të Republikës së Kosovës, KRU Radoniqi-Dukagjini Sh.A me datë 13/04/2023 shpall këtë:

Kompania Regionale e Ujitjes-SH.A  
Regional Irrigator Company J.S.C  
Regionalna Kompanija za Navodnjavanje-D.D  
"Radoniqi-Dukagjini"  
Nr. Prot. 344 DALJE  
Data 13-04-2023

## K O N K U R S

### PËR PRANIMIN E PUNËTORËVE SEZONAL DHE TË RREGULLT

Shpallim plotësimin e vendeve të lira të punës për pozitat:

Pozita 1: Një rojtar objekti në Njësinë Operative "Xërxe", Rahovec.

Pozita 2: Një ujtari për punë sezonale në Njësinë Operative "Dukagjini" në Prizren.

Pozita 3: Një rojtar për punë sezonale në Njësinë Operative "Dukagjini" në Prizren.

#### Detyrat për pozitën e ujtarit - regjistruarit

- Kujdeset për gypsjellësat, avaritë, shfrytëzimin e ujit. Intervenon në eliminimin e avarive dhe manipulon me mekanizmat për ndërprerjen dhe lëshimin e ujit në rrjetin e ujitjes
- Përpilon regjistrin e kulturave dhe sipërfaqeve të ujitura
- Pengon dhe me kohë informon për shfrytëzimin ilegal të ujit dhe kyçjet ilegale
- Kryen edhe punë të tjera sipas nevojave të Kompanisë me urdhër të udhëheqësit

#### Detyrat për pozitat e rojtarit

- Kujdeset dhe ruan objektet, materialin e deponuar në objekte të mbyllura në depo. Ruan materialin e deponuar në hapësirat jashtë objekteve-depove. Në raste të vërejtjes së rrezikut nga zjarri apo rreziqeve të tjera, merr masat më efikase dhe menjëherë kërkon ndihmë për evitimin e tyre.

#### Kualifikimi:

- Për pozitat nën një dhe dy kandidatët duhet t'a kenë të kryer shkollën e mesme.
- Për pozitën nën tre kandidatët preferohet t'a kenë të kryer shkollën e mesme.

#### Kushtet:

- Të ketë përvojë në punë dhe në detyra të ngjajshme
- Të jenë në gjendje që t'i kryejnë detyrat e punës me përgjegjshmëri
- Te jenë në gjendje të punojnë nën presion dhe jashtë orarit të punës
- Të kenë aftësi komunikimi, raportimi dhe përshtatshmërije në punë ekipore.

#### Procedura e aplikimit dhe dokumentacioni i nevojshëm:

- Kërkesa dhe CV
- Diploma përkatëse, certifikatat e trajnimeve
- Dëshmi mbi përvojën në punë
- Certifikata e lindjes dhe kopja e letërnjoftimit
- Dëshmi të mos të jenë të dënuar dhe nën hetime

- ✓ **Kandidatët e interesuar mund t'a dorëzojnë dokumentacionin e kërkuar në ndërtesën administratës së Drejtorisë së Kompanisë Regionale të Ujitjes Radoniqi-Dukagjini Sh.A që gjendet në Gjakovë, rruga e UÇK-së. p.n.**  
**Konkursi është i hapur 15 ditë nga dita e publikimit në gazetë.**